

KONTRATË
MBI "THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË"
"G Naku"

Sot, me datë **14/02/2023**, në Shkodër, Shqipëri, personi i mëposhtëm:

Z. Geri Naku, shtetas shqiptar, lindur më **02/08/1992** lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J20802112F** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Dhe Z. Ron Naku, shtetas shqiptar, lindur më **15/12/1997** lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J71215082K** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosi të themelojë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anetarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është "**G Naku**", këtu e më poshtë e quajtur "**Shoqëria**". Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.

NENI 2

Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Rruga e Pazarit , me nr. Pasurie 19/499, zona kadastrale 8597, Shkoder**



Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë;

Lavash, shit-blerje automjete, Import automjete, makina me qera.

NENI 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në QKB.

NENI 5

Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 200.000 Lekë (dyqind mijë).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportin e mëposhtëm;

-nga Z. Geri Naku, 90% e kapitalit, me 1 kuotë, Kapitali I hedhur: 180.000lek

- nga Z. Ron Naku, 10% e kapitalit, me 1 kuotë, Kapitali I hedhur: 20.000lek

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.



NENI 6
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime. Ne kete rast Asambleja perbehet nga ortakët e shoqerise, Geri Naku dhe Ron Naku

NENI 7
Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Z. Geri Naku, shtetas shqiptar, lindur më më **02/08/1992**, lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J20802112F** madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar

Mandati i Administratorit është për një periudhe prej 5 (pesë) vitesh, Nga Data 14.02.2023 – 14.02.2028. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

NENI 8
Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet ne fuqi.

Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor 2023.



NENI 9
Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKET E SHOQËRISË

GERI NAKU

GERI NAKU



RON NAKU

Ron Naku

